



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborna komisija za žalbe i molbe

A nr. 36/ 2009

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, në panelin e përbërë nga Osman Tmava, kryesues, Fahredin Ymeri dhe Muharrem Shala, anëtarë, përkitazi me ankesën e Koalicionit VAKAT – dega në Pejë, në seancën e mbajtur më datë 2.11.2009, mori

VENDIM

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

ARSYETIMI

Z. Hysnija Beskovic nga Koalicioni VAKAT, dega në Pejë, më datë 22.10.2009, ka parashtruar ankesë me të cilën pretendon se subjekti politik Stranka Demokratske Akcije (SDA), përkatësisht dy kandidatë në listë të këtij subjekti, Rahman Bibuljica dhe Edim Agovic, janë edhe spikerë zyrtar të Radio Hajatit, prone e kryetarit të SDA-se Numan Baliq.

FAKTET

Më datë 27.10.2009, KZAP-i ka pranuar një ankesë nga Koalicioni VAKAT – dega në Pejë të datës 22.10.2009, me të cilën pretendon se subjekti politik Stranka Demokratske Akcije (SDA), përkatësisht dy kandidatë në listë të këtij subjekti, Rahman Bibuljica dhe Edim Agovic, janë edhe spikerë zyrtar të Radio Hajatit. Me këtë rast, ankuesi pretendon se ky është konflikt i interesit sepse pronar i radios si dhe kryetar i partisë është Numan Baliq. Që të dy spikerët promovojnë në këtë mënyre vetveten dhe janë të njëanshëm.

ANALIZË

Jurisdiksioni i KZAP-it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP* (Ligji nr 03/L- 073) dhe *Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës* (Ligji nr 03 / L-072).

Rregullave dhe Procedurave, po ashtu Neni 6.4 përcakton që Panelet mund ta refuzojnë me procedurë të shpejtë ankesën apo një grumbull ankesash, të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore apo ato të cilat sipas mendimit të tyre nuk paraqesin një rast *prima facie*.

Për më shumë, bazuar në Nenin 3.4 të Rregullave dhe Procedurave të KZAP-it, përveç nëse nuk është saktësuar ndonjë afat tjetër, ankesa duhet të dorëzohet brenda tri ditëve pas ndodhjes së shkeljes së pretenduar apo brenda tri ditëve pasi që për shkeljen e pretenduar është njoftuar parashtruesi i ankesës ose nga dita kur ai është dashur të dijë për të.

Meqenëse ankesa është nënshkruar më datë 22.10.2009 kurse KZAP ka pranuar këtë ankesë më datë 27.10.2009, KZAP-i gjykon se nuk është respektuar Neni 3.4, kështu që është e papranueshme.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

A nr. 36/2009 më datën 2.11.2009.

